




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opshtine/Mayor's Office

Nr. 02 / 26

Datë: 23 / 01 / 2024

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), të nenit 90 dhe 91 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, në pajtim me nenin 8 pika 2, nën-paragrafi 2.2, nenin 9, nenin 10 dhe nenin 12 të Rregullores për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 17/2015, duke u bazuar në propozimin e drejtorisë përgjegjëse në fushën e menaxhimit emergjent dhe në konsultim me drejtoritë tjera, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni Lokal për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.
- II. Komisionin nga pika 1 të këtij vendimi e përbëjnë:
 - 1) Albulenë Emini, kryetare
 - 2) Skënder Dauti, sekretar
 - 3) Bajram Gashi, anëtar
 - 4) Adelina Ismajli, anëtare
 - 5) Bashkim Ahmeti, anëtar
 - 6) Hamide Hoxha, anëtare
 - 7) Shqipe Rexhaj, anëtare
- III. Komisioni i përbërë nga pika 2 e këtij vendimi emërohet për periudhën katër (4) vjeçare, përfshirë edhe sekretarin e komisionit i cili kryen punët nga paragrafi 2 i nenit 10 të kësaj rregulloreje.
- IV. **Detyrat e sekretarit të komisionit lokal janë si në vijim:** siguron kushtet e nevojshme për punë të papenguar të komisioneve nga paragrafi 2 i nenit 8 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë mjetet e transportit, pajisjet për llogaritje, hartat e nevojshme nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, mjetet e matjes, fotoaparate, kamerë, formularët e paraparë me këtë rregullore, hapësirën e punës ku komisioni do t'i kryej punët e tij profesionale, administrative dhe punët tjera (merr pjesë në vlerësimin e dëmeve).
- V. **Detyrat e komisionit lokal janë si në vijim:**
 - 1.1. organizon numrin e nevojshëm të komisioneve profesionale për vlerësimin e dëmeve dhe përcakton zonën përkatëse për secilin komision. Në rastet e dëmeve të përmasave të vogla vlerësimin e dëmeve e kryen vet komisioni lokal;
 - 1.2. cakton afatin deri kur duhet të kryhet vlerësimi i dëmeve;
 - 1.3. kujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje;

- 1.4. bashkon punën e të gjitha komisioneve profesionale në territorin e komunës dhe ju ofron ndihmën e nevojshme profesionale;
- 1.5. përpilon raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës dhe ia dorëzon kryetarit të komunës për shqyrtim;
- 1.6. raportin e miratuar nga asambleja komunale ia dorëzon Agjencisë në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit dhe një kopje ia dorëzon komisionit qendror;
- 1.7. propozon prioritetet për shfrytëzimin e mjeteve të ndara për sanimin dhe mënjanimin e pasojave që kanë ndodh nga fatkeqësia dhe për këtë e njofton kryetarin e komunës dhe
- 1.8. mbanë evidencë për dëmet e shkaktuara në territorin e komunës.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.
- VII. Shfuqizohet vendimi me numër protokolli: 02 / 613 /, të datës: 11 / 02 / 2023.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet sipas legjislacionit në fuqi.

Iu dërgohet:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Komunës



Qemajl Aliu

Kryetar i Komunës